



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

**AC-I-22-0566**

***Në ankesën e***

***Paditësi/Ankuesi***

**I R,** Podujevë.

***Kundër***

***E paditura***

**NSH, FAN "Zahir Pajaziti"** Podujevë (në likuidim), të cilën e përfaqëson, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakërishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe, Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-2822 të datës 20 shtator 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 18 tetor 2023, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e paditësit është pjesërisht e bazuar.**
- 2. Ndryshohet pjesërisht Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-2822 të datës 20 shtator 2022.**
- 3. Obligohet AKP-ja që në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës ti paguaj paditësit shumën**

**prej 1050,93 euro, interesin ligjor prej 10% në shumë prej 105,09 euro, si dhe shpenzimet e përfaqësimit nga ana e Avokatit në shumë prej 208 euro, të cilat do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.**

**4. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-2822 të datës 20 shtator 2022, për pjesën e kërkesës për tej shumës së aprovuar.**

**5. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

### **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 15 prill 2014, paditësi përmes postës e ka dërguar një ankesë në DHPGJS dhe ka kërkuar që të anulohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN046-0846 i datës 24 mars 2014, me të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën e pa përcaktuar. Autoriteti i Likuidimit ka konstatuar se paditësi ka punuar për NSH Fan "Zahir Pajaziti", në Podujevë nga data 16 gusht 1985, e deri me 24 mars 2006, mirëpo ligji relevant i kohës që ishte i zbatueshëm gjatë aktivitetit të ish AKM-së, nuk ka dhënë shprehimisht të drejtë punëtorëve të kërkojnë dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës e cila e drejtë më vonë njihet me Ligjin nr. 03/L-067 për AKP-në, dhe atë që nga qershori i vitit 2008. Tutje Autoriteti i Likuidimit ka konstatuar se paditësi kërkesën e tij nuk e ka parashtuar në afatin e duhur ligjor në ndonjë Gjykatë apo Autoritet kompetent. Në ankesë paditësi ka pohuar se në NSH ka punuar deri me 24 mars 2006, kur kjo ndërmarrje është privatizuar. Ai pohon se e ka pranuar Njoftimin nga ana e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 24 mars 2006, dhe duke u bazuar në këtë njoftim, pastaj ai pas fillimit të procedurave të likuidimit ka paraqit kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit lidhur me kompensimin e tij për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës. Në ankesë ai pretendon se i ka më shumë se 30 vite përvojë pune në ndërmarrje, andaj ka të drejtë në paga në kompensim në shumë prej 680 euro si dhe interesin ligjor, prej 10%. Bashkë me këtë ankesë

paditësi ka bashkangjitur Kopjen e autorizimit për përfaqësuesin, Kopja e vendimit të Autoritetit të Likuidimit, dhe kopjen e Letërnjoftimit.

Me datë 03 qershor 2020, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë për rregullim dhe plotësim të padisë. Në këtë parashtresë paditësi në emër të kompensimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës i kërkon 6 paga në shumë prej 2.101,86 euro, e po ashtu kërkon interesin ligjor dhe shpenzimet e përfaqësimit në shumë prej 104 euro dhe kompensimin e taksave gjyqësore prej 20 euro. Bashkë me këtë parashtresë dërgon Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, një Listë të pranimit të Njoftimeve për ndërprerje të marrëdhënies së punës, dhe Listën e pagave të punëtorëve për tre muajt e fundit, në të cilën listë paditësi është në numrin rendor 125, dhe një kopje të Listës së AKP-së për të drejtën legjitime për 20%.

Me datë 01 qershor 2022, AKP-ja e dorëzon mbrojtjen në ankesë. AKP-ja mbanë qëndrimin se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. Tutje AKP-ja pohon se paditësi nuk ka sjellë dëshmi për të vërtetuar se ai këto paga i ka kërkuar më herët në ndonjë gjykatë kompetente, andaj kërkesat janë parashkuar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. AKP-ja pohon se ankuesi nuk ka paraqitur në ankesën e tij i cili nen i Ligjit të AKP-së është shkelur me vendimin e ankimuar. AKP-ja pohon se njoftimi i AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës nuk mundet të konsiderohet asnjëherë si pranim i borxhit, duke pohuar se kjo letër ka të bëjë me realizimin e të drejtës nga lista për 20%. Në mbrojtjen në ankesë ajo ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar.

Me datë 20 shtator 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-2822, e refuzon ankesën e paditësit si të pabazuar dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se paditësi ishte një punëtor i NSH Fan "Zahir Pajaziti" në Podujevë i cili ka pretenduar se ka qenë punëtor i saj nga viti 1985 e deri në momentin e privatizimit me 24 mars 2006. Tutje Shkalla e I-rë ka

konstatuar se paditësi nuk e ka kërkuar kompensimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës në afatin prej tri viteve, por kërkesën e ka parashtruar tek Autoriteti i Likuidimit me datë 14.10.2013, çka do të thotë se kërkesa është parashkruar. Andaj në kuptim të nenit 376 paragrafi 1 i LMD-së është refuzuar ankesa e paditësit dhe është vërtetuar vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit, pasi që kërkesa është parashkruar.

Me datë 18 tetor 2022, paditësi e dorëzon në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-14-2822 të datës 20 shtator 2022, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkeljeve të dispozitave të së drejtës materiale, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e tij si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të anulohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit, të aprovohet padia si e bazuar dhe të detyrohet NSH-ja e paditur ti paguaj paditësit shumën prej 2.101,86 euro si kompensim për paga të pa paguara, për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës, interesin ligjor si dhe shpenzimet e përfaqësimit prej 416 euro, dhe kompensimin e taksave gjyqësore prej 40 euro. Për më tepër në ankesë paditësi ka pohuar se atij i është dërguar njoftimi i AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 24 mars 2006. Paditësi në ankese pohon se ai ishte punëtorë i NSH-së deri në ditën e privatizimit me datë 24 mars 2006, dhe ai ka të drejtë ti kompensohen pagat e pa paguara për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 24 mars 2006. Paditësi pohon se kërkesa nuk është parashkruar siç pretendon e paditura dhe shkalla e I-rë e DHPGJS-së, pasi që ai ka pranuar Njoftimin zyrtar për ndërprerje të marrëdhënies së punës në të cilën ceket se "shumat e pagave që u janë mbetur borxh sipas Kontratës suaj të punësimit do të mbesin në përgjegjësin e punëdhënësit, ndërsa kërkesat do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura". Tutje paditësi ka pohuar se arsyetimi i refuzimit të kërkesës me dispozitat për parashkrim është i gabuar dhe jo në pajtim me praktikën e DHPGJS-së dhe të Kolegjit të Apelit. Paditësi i referohet disa rasteve nga jurisprudenca e Kolegjit të Apelit dhe pohon se tashmë është formuar një qëndrim i njëjtë, andaj

konstatimet e shkallës së parë janë të gabuara dhe bien ndesh me praktikën e Kolegjit të Apelit.

Me datë 20 dhjetor 2022, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës paditësit. Në këtë parashtresë AKP-ja e kundërshton ankesën e paditësit si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj. Tutje AKP-ja ka pohuar se në mbrojtjen në padi ka sqaruar mjaftueshëm lidhur me argumentet e ngritura të ankesës dhe përsëritja e atyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja po ashtu ka pohuar se kërkesa e paditësit është parashkruar.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS, pjesërisht duhet ndryshuar për shumën e aprovuar prej 1.050,93 euro në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës, ndërsa lidhur me pjesën tjetër të kërkesës për tej shumës së aprovuar, Aktgjykimi vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 14 tetor 2013, e ka dorëzuar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit dhe i ka kërkuar që ai të kompensohet për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në të cilën kërkesë paditësi nuk e ka specifikuar shumën e kërkuar. Me ankesën e dorëzuar në shkallën e I-rë, paditësi e specifikon shumën prej 680 euro dhe kërkon 4 paga të papaguara.

Kjo kërkesë është refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se në kohën e Ligjit të zbatueshëm të veprimit të AKM-së, nuk është përcaktuar kjo kërkesë që mund ti njihet parashtruesit edhe pse ai në bazë të arkivës së ndërmarrjes shihet se ishte në punë në NSH Fan "Zahir Pajaziti", në Podujevë nga data 16 gusht 1985 e deri në 24 mars 2006. Autoriteti i Likuidimit kishte konstatuar se kjo kërkesë mund ti njihet parashtruesit vetëm pas qershorit 2008, kur është aprovuar Ligji i AKP-së, gjë që në këtë rast paditësi nuk e ka përfill afatin ligjor duke mos dorëzuar kërkesën brenda 3 viteve, andaj kjo kërkesë është parashkruar në bazë të nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se paditësi me parashtresën e datës 03 qershor 2020, e ka rregulluar dhe plotësuar të padinë. Në këtë parashtresë paditësi në emër të kompensimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës i kërkon 6 paga në shumë prej 2.101,86 euro, e po ashtu kërkon interesin ligjor dhe shpenzimet e përfaqësimit në shumë prej 104 euro, dhe kompensimin e taksave gjyqësore prej 20 euro. Bashkë me këtë parashtresë paditësi dërgon Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, një Listë të pranimit të Njoftimeve për ndërprerje të marrëdhënies së punës, dhe Listën e pagave të punëtorëve për tre muajt e fundit, në të cilën listë paditësi është në numrin rendor 125, dhe një kopje të Listës së AKP-së për të drejtën legjitime për 20%.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e ka pranuar qëndrimin ligjor të Autoritetit të Likuidimit se kërkesa është parashkruar. Ky konstatim i Autoritetit të Likuidimit dhe i shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i gabuar, dhe nuk ka bazë të qëndroj në bazë të prova që i ka sjellë paditësi në dosje.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me parashtresën e tij për rregullim dhe plotësim të padisë ka sjell Njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 24 mars 2006, një Listë të pranimit të Njoftimeve për ndërprerje të marrëdhënies së punës, dhe Listën e pagave të punëtorëve për tre muajt e fundit, në të cilën listë paditësi është në numrin rendor 125. Kjo Listë është e nënshkruar

nga menagjmenti i NSH-së. Në bazë të kësaj Liste borxhi i mbetur i NSH-së ndaj paditësit ishte 1.050,93 euro.

Bazuar në këto prova të cilat janë të mjaftueshme, Kolegji i Apelit konsideron se Shkalla e I-rë e DHPGJS-së pa të drejtë e kishte refuzuar tërësisht ankesën e paditësit dhe e kishte vërtetuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Kolegji i Apelit nuk e mbështet konstatimin e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së dhe të Autoritetit të Likuidimit se kjo kërkesë e paditësi është parashkruar. Kjo kërkesë buron dhe mbështet në Njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Paditësi bazuar në udhëzimet e dhëna në këtë njoftim ai me kohë është paraqitë në procedurën e likuidimit. Ky Njoftim siç ka konstatuar shumë herë Kolegji i Apelit në jurisprudencën e tij e ndërpre në rrjedhën e afatit të parashkrimit të kërkesës.

Andaj nga këto arsye, ankesa e paditësit pjesërisht aprovohet si bazuar për shumën prej 1.050,93 euro, aq sa është caktuar borxhi i NSH-së në Listën e pagave të punëtorëve, ndërsa refuzohet për pjesën e kërkuar për tej shumës së aprovuar, pasi që kjo pjesë e kërkesës nuk ka mbështetje në prova.

Paditësit në bazë të nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së i njihet e drejta në interes ligjor në shumë prej 10% në borxhin kryesor ose në shumë prej 105,09 euro, e cila së bashku me borxhin kryesor paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Duke u bazuar në nenit 62.2 të LDHP-së e paditura obligohet ti paguaj paditësit edhe shpenzimet e përfaqësimit nga ana e Avokatit prej 208 euro, që do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

**Taksat gjyqësore**

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore në shumën prej 20 euro, me datën 17 nëntor 2022, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së 18 tetor 2023.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues

\_\_\_\_\_